



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK KORÇË

Nr. 33 prot.

Data 12.01.2023

Lënda: Njoftim për vend të lirë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional". Ofruesi publik i AFP-së: Drejtoria Rajonale e Ofrit të Formimit Profesional Publik, Korçë ju njofton krijimin e vendeve të lira për pozicionet instruktorë me kohë të pjesshme :

- a) Instruktor me kohë të pjesshme të kursit KUZHINË ---- 2 persona
- b) Instruktor me kohë të pjesshme të kursit INSTALIME DHE MIRËMBAJTJE HIDRAULIKE ---- 1 person
- c) Instruktor të kursit me kohë të pjesshme GRAPHIC DESIGN ---- 1 person
- d) Instruktor të kursit me kohë të pjesshme INSTALIM DHE MIRËMBAJTJE E RRJETIT ELEKTRIK ---- 1 person
- e) Instruktor të kursit me kohë të pjesshme SERVIS XHENERIK NË AUTOMJETE TË LEHTA ---- 1 person
- f) Instruktor të kursit me kohë të pjesshme MANIKYR-PEDIKYR ---- 1 person
- g) Instruktor të kursit me kohë të pjesshme MOBILERI ---- 1 person
- h) Instruktor të kursit me kohë të pjesshme RROBAQEPSI ---- 1 person
- i) Instruktor të kursit me kohë të pjesshme SALDIM ---- 1 person
- j) Instruktor të kursit me kohë të pjesshme START SMART ---- 1 person

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në fushën/profesionin e kursit/kurseve të formimit profesional, për të cilin po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;
- të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës

31.01.2023

DREJTOR

Anxhela TAHO

